Gjatë vitit 2015 janë deklaruar 1123 punëmarrës me sëmundje profesionale, duke e krahasuar me vitin 2014 ku ky numër ishte 1853, kemi ulje të numrit të punëmarrësve me sëmundje profesionale, kjo si pasojë e kontrollit të vazhdueshëm dhe insistues nga Inspektorati i Punës në drejtim të marrjes së masave kolektive dhe individuale të mbrojtjes, si dhe rritjes së numrit të subjekteve të cilat mbulohen me shërbim mjekësor.

Numri i punëmarrësve që punojnë në vende pune të rrezikshme është 13423, ndërsa numri i punëmarrësve që punojnë drejtpërdrejt me substanca të rrezikshme është 3371.

Nga analizimi i të dhënave nga tabela përta përta i përket substancave të rrezikshme rezultoi se:

Në Berat përdoren 48 lloje substancash të rrezikshme si: Karburante, Diluent, Mastiç.

Në Durrës përdoren 7 lloje substancash të rrezikshme si: Metanol, sodë kaustike, benzinat, pluhur gipsi, çimento reagen, butan, propan, pluhur argjili.  
Në Elbasan përdoren 52 lloje substancash të rrezikshme si: Derivate të hidrokarbureve, Naftë dhe nën produktet e saj, Squfur, Koks, Plumb, Karbon, Zink, Solar, Krom dhe komponentët toksik, lëndë plasëse.

Në Fier përdoren 10 lloje substancash të rrezikshme si: Benzin, Naftë etj.  
Në Gjirokastrë përdoren 8 lloje substancash të rrezikshme si: Diluent, mastiç etj.  
Në Korçë përdoren 20 lloje substancash të rrezikshme si: HCl, Anoda Zinku, Sodë larëse, Bojra etj.

Në Kukës përdoren 36 lloje substancash të rrezikshme si: Benzol, Benzin, Dinamit, Çimento, Kapsolla, Pesticide, Herpicide etj.

Në Lezhë përdoren 14 lloje substancash të rrezikshme si: Diluent, karburante etj.  
Në Vlorë përdoren 60 lloje substancash të rrezikshme si: HCl, NH<sub>4</sub>OH, NaOH, CO<sub>2</sub>, CO, H<sub>2</sub>S, mbetje klinike, medikamente, rreze regten, pluhur silici etj.

Nga analizimi i të dhënave, vërehet një rritje e numrit të subjekteve që mbulohen me shërbim mjekësor, dhe numrit të subjekteve që përdorin paisje mbrojtëse kolektive dhe individuale kjo si pasojë e orientimit të procesit të inspektimit dhe takimeve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese me biznesin në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës, në subjektet që paraqesin risk për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve.

Gjithashtu vërehet një rritje e konsiderueshme e Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, dhe ekzistencës së dokumentit të vlerësimit të riskut, kjo si pasojë e kërkesës së vazhdueshme nga Inspektorati i Punës në këtë drejtim, jo vetëm për ngritjen e këtyre Këshillave por dhe në efektivitetin e tyre si dhe dokumenti i vlerësimit të riskut të jetë konform legjislacionit në fuqi.

## **ANALIZË E AKSIDENTEVE NË PUNË PËR VITIN 2015**

Pranë Sektorit të Insepektimit të Sigurisë në Punë nga muaji Janar 2015 deri më Dhjetor 2015, janë raportuar 125 raste të aksidenteve në punë, ku kanë mbetur të aksidentuar 133 punëmarrës, prej të cilëve 28 kanë humbur jetën.

Nga 125 punëmarrës të aksidentuar, 14 prej tyre janë femra dhe 111 meshkuj. Femrat e aksidentuara janë me pozicion pune punëtore, në subjektet me aktivitet prodhim, shërbime dhe telekomunikacion.

Mosha mesatare e punëmarrësve të aksidentuar është 43 vjeç. Punëmarrësit e aksidentuar, përveç rasteve me pasojë vdekje, kanë pësuar kryesisht diegie në fytyrë dhe këmbë, dëmtim të dorës, frakturë në shpinë apo këmbë, shembje trupore etj. Të aksidentuarit në fjalë përgjithësisht ishin me pozicion pune punëtor, zjarrmëtar, elektrikist, saldator, vagonist, mekanik, shofer.

Ndaj 18 subjektve janë vendosur masa administrative gjobë për shkelje të rregullave të sigurisë në punë, apo mosnjohim të aksidentit në punë pranë ISHPSHH-së. Në pjesën tjetër të rasteve janë vendosur dënime administrative paralajmërim për gjobë si dhe lënia e detyrave përkatëse me afatet respektive.



Nr.	Lloji i aksidentit	Të aksidentuarTotal	Me vdekje
1	Aksidente që lidhen direkt me punën	83 ( %)	16( %)
2	Aksidente që lidhen direkt me punën (pa minierat)	92 ( %)	18 ( %)
3	Aksidente në miniera	33 ( %)	10 ( %)
4	Aksidente në rrugë	9 ( %)	2 ( %)
<b>TOTAL</b>		<b>125</b>	<b>28</b>

Nga sa më lart, konstatohet që një numër i ndjeshëm i aksidenteve janë shënuar në miniera.

Janë regjistruar 9 të aksidentuar në rrugë, që përshfihen si aksidente në punë, 2 nga të cilët kanë humbur jetën. Këtu janë përfshirë si rastet kur punëmarrësi është aksidentuar gjatë linjës së drejtpërdrejtë nga banesa për në punë, si edhe rastet kur punëmarrësi po kryente punën sipas përshkrimit të saj dhe në këtë kohë është goditur nga një automjet.

Aksidentet që lidhen direkt me punën, duke përjashtuar aksidentet në miniera dhe në rrugë, përbëjnë 63.6% të rasteve të aksidenteve të ndodhura. Kjo është dhe shifra reale e punëmarrësve të aksidentuar gjatë kryerjes së punës sipas përshkrimit të saj, pasi kujtojmë këtu që aksidentet në miniera dhe ato në rrugë, nuk janë në kontroll të drejtpërdrejtë të punës së inspektorëve të punës.

Klasifikimi i aksidenteve sipas llojit të aktiviteteve:

Nga muaji Janar - Dhjetor 2015, në lidhje me aksidentet në punë, rezultojnë këto të dhëna:

NR	Lloji i aktivitetit	Të aksidentuar	Me pasojë vdekje
1	Bujqësi, Pyje, Peshkim	-	-
2	Miniera, Kariera	33	10
3	Ndërmarrje Prodhuese	23	1
4	Elektricitet, Gaz, Ujë	14	3
5	Tregti, BRH	5	0
6	Ndërtim	26	10
7	Telekomunikacion	4	1
8	Financë, Shërbime	8	0
9	Aktivitete të Tjera	12	3
<b>Totali</b>		<b>125</b>	<b>28</b>

Duke i klasifikuar aksidentet sipas llojit të aktivitetit, rezulton se sektorët më të prekur janë:

**Aktivitete Miniera, Kariera** ku janë regjistruar 33 të aksidentuar në punë, 10 prej të cilëve me pasojë fatale për jetën e punëmarrësve. Nje nga subjektet ku kanë ndodhur këto aksidente janë kariera.

Si shkaqe aksidenti janë përcaktuar moszbatim i rregullave të sigurimit teknik, rënie nën tension, rënie e një masivi dheu, mungesa e informimit dhe këshillimit të punëmarrësve. Këto aksidente kanë ndodhur në zonën e Dibrës, Shkodrës dhe Kukësit. Në Dibër (Bulqizë) janë regjistruar shtate raste të aksidenteve masive, ku dy punëmarrës në secilin nga gjashte raste dhe tre punemarres në nje rast tjetër, janë dëmtuar në të njëjtën kohë dhe për shkak të së njëjtës arsye.

Gjithashtu, ka pasur raste të aksidenteve të përsëritura në të njëjtin subjekt, ku problematike paraqitet zona e Bulqizës, në subjektin “Albchromë” kanë ndodhur 14 raste aksidenti në punë, dy ndër të cilët me pasoja fatale për jetën e punëmarrësit të aksidentuar.

Për hetimin e aksidenteve të ndodhura në miniera është bashkëpunuar me RISHM-in, ku inspektorët e punës plotësojnë procesverbalin e ISSH-së bazuar në relacionin e hetimit të aksidentit të përgatitur nga inspektorët e RISHM-it. Përgjithësisht subjekteve në fjalë ku kanë ndodhur këto aksidente i janë dhënë masa administrative paralajmërim për gjobë.

**Aktivitete Ndërmarjet prodhuese**, ku janë regjistruar 23 të aksidentuar në punë, 1 prej të cilëve kanë humbur jetën.

Shkaqet kryesore të aksidenteve të këtij sektori janë moszbatimi i rregullave të sigurimit teknik, mungesa e mjeteve mbrojtëse kolektive, rënie nga lartësia, mos përdorimi i mjeteve mbrojtëse personale, shpërthim gazi, pakujdesi e punëmarrësit.

**Aktivitete Elektricitet, gaz, ujë** ku janë regjistruar 14 punëmarrës të aksidentuar, 3 prej të cilëve kanë humbur jetën.

Shkaqet kryesore të aksidenteve janë përcaktuar, goditjet nga rryma elektrike, aksident rrugor, moszbatim i rregullave të sigurimit teknik, mos përdorimi i mjeteve mbrojtëse personale.

Aksidentet kanë ndodhur në pjesën dërrmuese të rasteve në Subjektin”OSHEE’, të shpërndara në zonën e Tiranës, Kukesit, Lezhës, Berat. Theksojmë që përqëndrimi më i madh i aksidenteve ka ndodhur në zonën e Tiranës, ku janë hetuar 4 raste të aksidenteve në punë, me 4 punëmarrës të aksidentuar, nga te cilet 1 me pasoja fatale për jetën.

Subjektet janë sanksionuar me masa adminbistrative gjobë.

**Aktivitetet Ndërtim**, ku janë raportuar 26 raste aksidenti, ku 10 punëmarrës kanë humbur jetën.

Shkaqet kryesore të aksidenteve të këtij sektori rezultojnë të jenë rënie nga lartësia, moszbatim i rregullave të sigurimit teknik, mos marrja e masave mbrojtëse kolektive dhe individuale.

Në këtë sektor ka pasur raste të asidenteve të përsëritura në të njëjtin subjekt ku 2 aksidente me pasoje vdekje kanë ndodhur ne subjektin “Vellezerit Elezi” dhe 3 aksidente pa pasoja kanë ndodhur ne subjektin “Limak Age JV”.

Subjektet në të cilat kanë ndodhur këto aksidente janë sanksionuar me masa administrative gjorbë dhe janë lene detyrat perkatese per zbatim

**Aktivitetet Financë, shërbime** ku janë regjistruar 8 raste aksidenti pa pasoja fatale per jeten. Si shkaqe aksidenti janë përcaktuar pakujdesia e punëmarrësve, mungesa e rregullave të sigurimit teknik. .

**Aktivitetet Telekomunikacion** janë regjistruar 4 raste aksidente në punë, nje me pasoje vdekje.

Si shkaqe aksidenti janë përcaktuar mospërdorim i mjeteve mbrojtëse, rrëzimi nga shkallët si pasoje e mungesës së ndriçimit në një subjekt, si dhe aksident rrugor, çka do të thotë që përgjithësisht janë aksidente që nuk lidhen direkt me punën.

**Aktivitetet Të tjera**, kanë shënuar 12 raste aksidenti, 3 me pasoje vdekje. Si shkaqe aksidenti është përcaktuar rënia nën tension, pakujdesia e punëmarërsit, mospërdorim i mjeteve mbrojtëse personale.

Nuk ka pasur raste të aksidenteve masive apo raste të aksidenteve të përsëritura. Në sektorin e bujqësisë nuk është regjistruar asnjë rast aksidenti në punë. Klasifikimi i aksidenteve sipas Degëve Rajonale të ISHPSHSH-së:

Dega Rajonale	Nr. Rasteve	Nr.i të aksidentuarve	Me vdekje	Nr i të aksidentuarve në Rrugë
<b>Berat</b>	4	4	0	0
<b>Dibër</b>	30	37	8	0
<b>Durrës</b>	20	20	1	1
<b>Elbasan</b>	8	8	1	1
<b>Fier</b>	2	2	0	0
<b>Korçë</b>	9	9	3	1
<b>Kukës</b>	8	9	5	0
<b>Lezhë</b>	9	9	2	0

<b>Gjirokastrë</b>	1	1	-	-
<b>Shkodër</b>	6	6	3	0
<b>Tiranë</b>	24	24	4	6
<b>Vlorë</b>	4	4	1	0
<b>Totali</b>	125	133	28	9

## **KA NJË SËRË FAKTORËSH QË KANË NDIKUAR NË REGJISTRIMIN E NJË NUMRI MË TË LARTË TË AKSIDENTEVE NË PUNË:**

Numrin e lartë të aksidenteve të ndodhura në miniera (33 të aksidentuar, 10 prej të cilave me pasojë fatale për jetën e punëmarrësve).

Kujtojmë këtu që institucioni përgjegjës për kushtet e sigurisë në miniera është RISHM-i, dhe ligji rregullues është ligji që vepron në fushën e miniera. Ligji Nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, përjashton nga fusha e zbatimit të tij, të gjitha vendet e punës, ku inspektimi për marrëdhëniet e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë janë të rregulluara me ligje të veçanta.

Aksidentet me pasojë vdekje janë shënuar 10 në miniera dhe 10 në ndertim.

Për vitin 2015, janë regjistruar 8 aksidente rrugore, që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me marrëdhënien e punës, nga të cilët 2 punëmarrës kanë humbur jetën. Edhe për vitin 2014 janë shënuar 3 punëmarrës me pasojë vdekje si pasojë e aksidentit në punë.

Njoftimin e aksidenteve nga vetë punëdhënësit, të cilët edhe falë punës së inspektorëve të punës, janë ndërgjegjësuar për detyrimin ligjor të respektimit të ligjit, për të raportuar çdo rast aksidenti në punë, të ndodhur në subjektin e tyre, pranë ISHPSHSH-së dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Rritja e autoritetit të ISHPSHSH-së, ku trajtimi me seriozitetin e duhur i çdo rasti aksidenti në punë, ka rritur besueshmërinë e qytetarëve për të gjetur zgjidhje, duke mos pasur frikë në përballjen me institucionin në fjalë, si dhe nga ana tjetër ndërgjegjësimit që mosnjoftimi i aksidentit do ia rëndonte më tepër pasojat.

Përdorimi i burimeve të ndryshme të marrjes së informacionit, të tilla si mediat, puna investiguese e inspektorëve të punës, vetë punëmarrësit e aksidentuar, të cilët i janë drejtuar ISHPSHSH, për të bërë të ditur rastin e tyre, për të përfituar nga sigurimet shoqërore që mbulojnë rastet e aksidenteve në punë.

Rritja e numrit të subjekteve të licensuara, të cilët janë bërë pjesë e inspektimit nga ana e inspektorëve të punës.

Punësim më i lartë i punëmarrësve, që si i tillë rrit propabilitetin për të pasur më shumë të aksidentuar në punë.

Regjistrimi si aksidente në punë edhe i rasteve të lehta të aksidentimit, edhe ato kur përfitojnë mbi 3 ditë leje si pasojë e aksidentit. Në këtë kategori janë përfshirë subjektet me aktivitet tregti, prodhim, ndërkohë që për vitin 2014 raportimi për këtë raste aksidentesh ishte më i ulët.

Bashkëpunimi i mirë me institucionet e tjera, që ka shërbyer si burim informimi për aksidentet e ndodhura në punë.

Aksidentet e ndodhura në pjesën më të madhe të tyre, nuk janë aksidente të përsëritura në të njëjtën subjekt, me përjashtim të rasteve të aksidenteve të ndodhura në miniera, në Bulqizë. Kjo do të thotë që me hetimin e aksidenteve dhe lënien e detyrave përkatëse së bashku me afatet respektive për plotësimin e tyre, ka pasur reflektim nga ana e subjekteve për plotësimin e tyre.

### **KONSTATIME TË DALA NGA ANALIZIMI I AKSIDENTEVE NË PUNË DHE HAPAT E NDËRMARRË PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS.**

Subjektet në të cilat kanë ndodhur aksidente në punë janë sanksionuar me gjobë nga ana e inspektorëve të punës, si dhe janë lënë detyra konkrete për bërjen e vendeve të punës më të sigurta.

Këto aksidente përgjithësisht janë njoftuar në kohë nga subjektet pranë zyrave të ISHPSHSH-së, përveç pak rasteve, për të cilët është vendosur sanksion, që i është shtuar masës së gjobës që do merrte subjekti për shkelje të rregullave të sigurisë në punë.

Gjatë hetimit të aksidenteve, inspektorët e punës kryesisht kanë konstatuar shkeljet e mëposhtme:

- Mos zbatim i rregullave të sigurimit teknik, etj.
- Mosnjoftimi nga punëdhënësi për aksidentin e ndodhur, sipas afateve kohore të përcaktuara në ligj.
- Mosmarrja e masave mbrojtëse kolektive
- Mospajisja me mjete mbrojtëse individuale nga ana e punëdhënësit dhe në rastet kur janë dhënë, mospërdorimi i tyre gjatë punës nga punëmarrësit.
- Mungesa e informimit dhe këshillimit të punëmarrësve

Me qëllim përmirësimit e hetimit të një aksidenti dhe për më tepër të ardhjes në ndihmë të personave të aksidentuar në punë, për tu bërë pjesë e përfitimit të të ardhurave si pasoje e aksidentimit në punë, janë nxjerr problematikat që dalin nga rënie ndesh e Ligjit Nr. 10 237, datë 18.02.2010”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe të VKM Nr. 788, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës”.

Evidentimi çdo muaj i subjekteve ndaj të cilave janë dhënë dënime administrative gjobë, ose paralajmërim, për shkak të problematikave të tyre në fushën e sigurisë në punë.

Me qëllim të theksimit të rëndësisë së ngritjes së këshillit të sigurisë dhe efikasitetit të tij, Degët Rajonale të ISHPSHSH-së janë vënë në dijeni që, në raste të aksidenteve në punë të konstatohet dhe dokumentohet ekzistenca dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të këtyre këshillave gjatë hetimit të aksidenteve në punë.

## **KONTROLLI NË HOTELERI-TURIZËM**

**Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në periudhë sezoni turistik ka drejtuar punën e tij në inspektimet e subjekteve me mbingarkese aktiviteti. Analiza e këtyre treguesve statistikor të inspektimit në subjektet e Hoteleri-Turizmit realizuar gjatë muajve Korrik-Gusht 2015, paraqet këtë situatë:**

Gjatë muajve korrik – gusht 2015, sipas Urdhërit nr 1147 datë 02.07.2015 “Për evidentimin dhe kontrollin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sezonin turistik”, janë kontrolluar gjithsej 667 aktivitete të tilla.

Numri i punëmarrësve të evidentuar është 4669, me një mesatare punëmarrësish për subjekt 7.

Nga të dhënat e degëve rajonale rezultojnë që në Dibër nuk ka pasur inspektime në subjekte me aktivitet në sezonin turistik.

Numri më i madh i këtyre aktiviteteve është kontrolluar nga Dega Rajonale Vlorë, Shkodër, Durrës, Tiranë dhe Lezhë.

Mesatarja e punëmarrësve për subjekt është 10.1 në Vlorë, 8.3 në Lezhë, 8.3 në Tiranë.


E ulët kjo mesatare është në Gjirokastrë, Kukës me 2.1 punëmarrës për subjekt, e Fier me 2.9 punëmarrës për subjekt.

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat mbi subjektet dhe punëmarrësit e evidentuar nga 12 Qarqet Rajonale, të pasqyruara dhe në grafikun 1.1

<b>Degët Rajonale</b>	<b>Subjekte</b>	<b>Punëmarrës</b>	<b>Mesatare e punëmarrësve për subjekt</b>
<b>Berat</b>	28	121	4.3
<b>Diber</b>	0	0	0
<b>Durres</b>	85	568	6.7
<b>Elbasan</b>	7	52	7.4
<b>Fier</b>	44	126	2.9
<b>Gjirokaster</b>	16	34	2.1
<b>Korce</b>	62	214	3.5

<b>Kukes</b>	10	21	2.1
<b>Lezhe</b>	74	614	8.3
<b>Shkoder</b>	89	514	5.8
<b>Tirane</b>	77	637	8.3
<b>Vlore</b>	175	1768	10.1
<b>Total</b>	<b>667</b>	<b>4669</b>	<b>7.0</b>

Grafiku 1.1



Kontrolli i subjekteve, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sezonin turistik, ka si qëllim edhe evidentimin e punëmarrësve me turne.


Kështu tabela e mëposhtme jep në përqindje të punësuarit për çdo degë rajonale sipas regjimit të punës, së evidentuar.

Degët Rajonale	Perqindje e Punëma gjithsej, evidentuar në turn të I-të	Perqindje e Punëma gjithsej, evidentuar në turn të II-të	Perqindje e Punëma gjithsej, evidentuar në turn të III-të
<b>Berat</b>	66.9%	28.1%	5.0%
<b>Dibër</b>			
<b>Durrës</b>	57.7%	38.9%	3.3%
<b>Elbasan</b>	59.6%	25.0%	15.4%
<b>Fier</b>	77.8%	18.3%	4.0%
<b>Gjirokastër</b>	88.2%	11.8%	0.0%
<b>Korçë</b>	53.7%	43.9%	2.3%
<b>Kukës</b>	57.1%	42.9%	0.0%



<b>Lezhë</b>	53.6%	36.0%	10.4%
<b>Shkodër</b>	60.3%	37.9%	1.8%
<b>Tiranë</b>	63.0%	33.1%	3.9%
<b>Vlorë</b>	39.7%	42.1%	18.2%
<b>Total</b>	52.2%	37.9%	9.9%

Të shprehur dhe në grafik këto të dhëna paraqesin punën e çdo dege rajonale.  
Grafiku 1.2



Kështu nga të dhënat e Degës Rajonale Vlorë janë 42.1% e totalit të punëmarrësve të evidentuar që punojnë në turn të dytë dhe 18.2% në turn të tretë.

Po kështu në Degën Rajonale Lezhë gjatë këtij sezoni janë evidentuar 36% e totalit të punëmarrësve, në punë në turn të dytë dhe 10.4% në turn të tretë.

Vëmë në dukje që nga Dega Rajonale Durrës 3.3% e punëmarrësve të evidentuar punojnë në turn të tretë, apo në Shkodër ku vetëm 1.8% e totalit të punëmarrësve të evidentuar punojnë në turn të tretë.


Evidentimi i punëmarrësve në këto aktivitete e sidomos i punëmarrësve që punojnë në turn të dytë apo të tretë ka si qëllim inspektimin e marrëdhënies së punës dhe instruktimin e punëmarrësve e punëdhënësve duke synuar në marrëdhënie pune konform ligjit, formale e të bazuar në një kontratë pune korrekte.

Kështu të dhënat mbi numrin e punëmarrësve evidentuar në punë pa kontrata pune flasin për 932 punëmarrës ose 20% e totalit të punëmarrësve të evidentuar, që punojnë pa pasur një kontratë pune individuale.

Këto të dhëna për çdo degë rajonale jepen si më poshtë:

	Subjekte	Punemarres gjithes te evidentuar	Nr i Punëm gjithsej pa kontrate individuale	Perqindja e Punëm evidentuar pa kontrate individuale
<b>Berat</b>	28	121	13	10.7%
<b>Dibër</b>	0	0	0	
<b>Durrës</b>	85	568	74	13.0%
<b>Elbasan</b>	7	52	11	21.2%
<b>Fier</b>	44	126	2	1.6%
<b>Gjirokastrë</b>	16	34	6	17.6%
<b>Korçë</b>	62	214	35	16.4%
<b>Kukës</b>	10	21	7	33.3%
<b>Lezhë</b>	74	614	350	57.0%
<b>Shkodër</b>	89	514	3	0.6%
<b>Tiranë</b>	77	637	60	9.4%
<b>Vlorë</b>	175	1768	371	21.0%
<b>Total</b>	<b>667</b>	<b>4669</b>	<b>932</b>	<b>20.0%</b>

Grafikisht të dhënat mbi punëmarrësit e evidentuar në punë pa një kontratë pune për 12 degët rajonale janë:



Punësimi informal (ku përfshihen të gjithë punëmarrësit e evidentuar në punë në subjektet e licensuara dhe e për të cilët nuk derdhet kontributi i Sigurimeve shoqërore e shëndetësore), gjatë kontrollit për muajt korrik-gusht 2015, në këto aktivitete rezultojnë 420. Me masat e marra në këtë periudhë për t'i futur në skemën e Sigurimeve Shoqërore rezultojnë se 92% ose 385 punëmarrës tashmë rezultojnë të futur në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si rezultat i punës së bërë në këto inspektime.

Vëmë në vëmendje që edhe pse pritshmëritë ishin të larta për disa degë rajonale rezultati i punës në këtë periudhë nuk është ashtu siç duhet të ishte.

Kështu ka degë rajonale ku evidentimi i punësimit informal është 0 si: Berat, apo shifra të ulta si në: Elbasan, Kukës, Fier, Gjirokastrë.

Tabela e mëposhtme jep këto të dhëna për 12 degët rajonale.

	Subjekte	Punm	Nr. Punëm gjithsej të pasiguruar	Perqindja e Punëmarrësve të pasiguruar	Nr. Punëm gjithsej, që u futen në skemën e Sig	Perqindja e Punëmarrësve të pasiguruar, që u futen në skemën e Sigurimeve
<b>Berat</b>	28	121	0	0%	0	0%
<b>Dibër</b>	0	0	0	0%	0	0%
<b>Durrës</b>	85	568	55	10%	58	105%
<b>Elbasan</b>	7	52	4	8%	4	100%
<b>Fier</b>	44	126	9	7%	0	0%
<b>Gjirokastrë</b>	16	34	6	18%	6	100%
<b>Korçë</b>	62	214	24	11%	24	100%


<b>Kukës</b>	10	21	7	33%	0	0%
<b>Lezhë</b>	74	614	55	9%	55	100%
<b>Shkodër</b>	89	514	12	2%	0	0%
<b>Tiranë</b>	77	637	40	6%	37	93%
<b>Vlorë</b>	175	1768	208	12%	201	97%
<b>Total</b>	<b>667</b>	<b>4669</b>	<b>420</b>	<b>9%</b>	<b>385</b>	<b>92%</b>

Vlen të përmendim punën e disa degëve rajonale e sidomos asaj Vlorë e cila ka evidentuar dhe formalizuar 50% të punëmarrësve informal të kësaj periudhe të 12 degëve rajonale.

Po kështu edhe nga dega rajonale Lezhë është evidentuar dhe formalizuar puna e 55 punëmarrësve, të cilët punonin të pasiguruar.

Grafiku jep në përqindje e punës evidentuese të çdo dege rajonale mbi punësimin informal gjatë sezonit turistik.

Sigurisht në këtë grafik nuk përfshihen dega rajonale Dibër e cila nuk ka inspektime në kuadër të sezonit turistik.



## **ANALIZA VJETORE 2015, E PUNËS SË DREJTORISË SË INSPEKTIMIT TË STANDARTEVE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE.**

### **NDRYSHIMET LIGJORE PËR VITIN 2015.**

Për sa i përket ndryshimeve ligjore për vitin 2015, konstatojmë:

VKM 572 dt.24.06.2015 “Standartet për Shërbimet në Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencës”.

Projekt Ligji i ri “Për shërbimet Shoqërore” për të cilën kemi dhënë kontributin në: punë paraprake në konceptimin e ligjit të ri të shërbimeve shoqërore; aktor kryesor në rekomandimet dhe komentet për konfigurimin e këtij ligji;

Ky ligj përcakton ndryshime në drejtim të konceptimit të ri të kësaj drejtorie, si njësi kontrolli e pavarur.

Inspektimi i subjekteve publike dhe jopublike që ofrojnë shërbime shoqërore është realizuar sipas Matricës së Veprimtarisë të Planit Korrik 2015 – Korrik 2017 , të dërguar nga MMSR, në masën 80% .

Më poshtë ju paraqesim numrin e qendrave të përkujdesit shoqëror të inspektuara në vitin 2015:

Inspektime të planifikuara të realizuar me tematikë kontrolli dhe zbatim të detyrave të lëna:	96
Inspektime për qendrat e përkujdesit për marrjen e Liçensës nga QKL:	6
Inspektime të realizuar me kërkesë të MMSR , SHSSH, KSHB:	5
Inspektime me grupe pune të përbashkëta me SHSSH :	4

### **Gjithësej inspektime gjatë vitit 2015**

**111 inspektime**

Në inspektimet e realizuara janë lënë detyra me afate kohore, për zbatimin e të cilave, kemi hartuar një plan veprimi me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në qendrat e përkujdesit.

### **Problematikat e konstatuara në qendrat e përkujdesit:**

Mungesë e procedurave të ankimimit. Kutia e ankimimit pothuajse në të gjitha qendrat nuk kryen funksionin, nuk ka procesverbale për hapjen e saj dhe procedura të shkruajtura dhe në ato pak raste që mund të ketë ndonjë ankimim, nuk ka përfaqësues nga pushteti vendor dhe shërbimi social rajonal në komisionin për hapjen e kutisë. Për këtë problem, i kemi tërhequr vëmendje të gjitha qendrave të përkujdesit shoqëror me një shkresë me Nr.31 prot

dt.07.01.2016, që të marrin masat që procedurat e ankimit të zbatohen, ashtu siç e parashikon standarti përkatës.

Institucionet ende janë të fokusuar në zbatimin e standarteve që lidhen me aspektet fizike (ushqimi, veshja, akomodimi,) dhe kanë vështirësi në zbatimin e standarteve që lidhen me aspektet psiko-sociale të klientëve, me përfshirjen sociale, rintegrimin, pjesmarrjen e prindërve/të afërmeve në procesin e hartimit të planeve individuale, lidhjet me komunitetin etj.

Njohja me standartet për shërbimet e reja si shërbimi i emergjencës, shërbimi në familje.

Në disa institucione personeli ka mangësi në drejtim të figurave profesionale dhe kapaciteteve/kualifikimeve profesionale për trajtimin e fëmijëve sipas grup-moshave, zhvillimit psikologjik dhe trajtimin e nevojave të veçanta të tyre, sidomos mungesa e mjekut psikiater, kryesisht në qarqet (përfshijë Tiranën) ku ka mungesë të theksuar mjekesh specialistë.

Vështirësi konstatohen në funksionimin e ekipeve multidisiplinare dhe adresimin e nevojave të fëmijëve në strukturat përkatëse.

Zbatimin e procedurave, hartimin e planeve të përkujdesit social sipas formatit të miratuar në dosjet e përfituesve dhe punës së diferencuar me programe të veçanta për secilin kategori përfituesve

Ndjekja e procedurave për marrjen e kujdestarisë ligjore me vendim gjykate, mbështetur në Udhëzimin Nr 06. dt 21.05.2011 po ecën me ritme të ngadalshme (sidomos në Institucionet Jopublike) për shkak të zvarritjes së proceseve gjyqësore, neglizhencës së personelit dhe vështirësive për të kontaktuar me familjarët e fëmijëve të vendosur në institucione.

Në qendrat rezidenciale dhe ditore për Personat me Aftësi të Kufizuar është domosdoshmëri hartimi për plane integrimi, ku në bazë është përfshirja sociale e PAK, bazuar në standartet.

Nevoja e trajnimit të burimeve njerëzore (punonjës social, psikolog, infermiere, fizioterapistë, kujdestarë, edukatorë duke përfshirë dhe prindërit e klientëve).

Zgjerimi i tipologjisë së shërbimit për punë të diferencuar për target-grupe të veçanta si fëmijët me prapambjetje institucionale.

Përmirësimi i infrastrukturës për fasilitetin e përkujdesit ndaj përfituesve si pajisja me si mjete elektro-shtëpiake industriale, automjete për transportin e tyre, kamera për mbrojtjen nga abuzimi dhe dhuna, në institucionet e përkujdesit shoqëror.

Nga inspektimet kemi konstatuar disa ambjente në disa institucione të cilat kanë nevojë të merremtohen nga ekzistenca e lagështirës, të lyhen ambjentet dhe godina, të jenë më të përshtatshme, brenda standarteve që kërkojmë. Për këtë

qëllim janë njoftuar strukturat përkatëse mbi gjendjen fizike të tyre dhe janë lënë detyra me afate kohore për rehabilitimin e tyre.

### **Masat e marra në vitin 2015**

- Paralajmërim për mbyllje të aktivitetit për mosplotësim të detyrave të lëna në afatin e përcaktuar kohor, për qendrën pritëse Viktima të Trafikimit, Linzë Tiranë.
- Në koordinim me Ministrin e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, është marrë masa e menjëhershme largim nga puna i Znj. Anjeza Gjeluçi Drejtore e Shtëpisë së Fëmijës parashkollor Shkodër, dhe tre kujdestarëve që përdorën dhunë me fëmijët e qendrës.
- Paralajmërim për mbyllje të aktivitetit të qendrës “Joshua Center” për mosplotësim në kohë të detyrave të lëna.

## **AKTIVITETE 2015**

- 11-11.2015 Inspektoriati Shtetëror I Punës, mori pjesë në një forum biznesi të organizuar nga Dhoma Amerikane e Tregtise me temë “ Cfare duhet të dije biznesi kur Inspektori i punës vjen për kontroll” Ky forum ishte konceptuar si një tryeze e rrumbullakët bashkëbisedimi për pyetje apo sqarime të perfaqesuesve të sipërmarrjes private në raport me marrëdhënien e punës dhe ligjshmerine e saj. Stafit teknik të Inspektoriatit të Punës ju përgjigj dhe sqaroi deri në detaje për çështjet e ngritura nga perfaqesuesit e biznesit
- 15.05.2015. Kryeinspektori z.Dritan Ylli zhvilloi ka zhvilluar një takim me të gjithë trupën inspektuese të terrenit. Mbi rezultatet e arritura gjatë vitit 2014 dhe rritjen e besueshmerise ndaj institucionit dhe kërkoi me shumë punë dhe profesionalizem nga trupa inspektuese, për të tejkaluar këto rezultate të mira të arritura, duke mos u matur me me periudhat e mëparshme, por duke rendur në rritjen e standarteve dhe respektimin e marrëdhënies së ligjshme në mes të punëdhënësve dhe punëmarresve.
- Drejtori i Inspektoriatit të Punës Dritan Ylli ka marrë pjesë në konferencën Europiane për sigurinë dhe shëndetin në punë, që u zhvillua në Riga të Letonisë. Në këtë konferencë merrnin pjesë drejtues të Inspektoriatëve të Punës të shteteve anëtare të BE dhe vendeve kandidatë. Gjithashtu në konferencë ishin edhe drejtues të lartë të BE , që mbulojnë çështjet e punësimit. Gjatë konferencës u evidentua nevoja e bashkëpunimit në mes të punëdhënësve dhe punëmarresve për të pasur një dialog në mes tyre në mënyrë që të dyja palët të japin kontributin e tyre për të pasur vende pune më të sigurta dhe të shëndetshme.
- Seminar sensibilizues dhe informues për rregullat e reja të dalës në zbatim të ligjit 10237 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë” i mbajtur në Tiranë me bizneset më të mëdha që operojnë në tregun Shqiptar.





## **OBJEKTIVAT PËR VITIN 2016.**

- Rritja e standarteve të punës, përmes dixhitalizimit të arkivës së dosjeve të inspektimit të arshivuara pranë Degës Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë dhe kryerjes së procesit të inspektimit përmes portalit “e-inspektimi”, në bashkëpunim me Inspektoratin Qëndror.
- Rritja e efektivitetit të inspektimit duke përmirësuar të gjithë treguesit e inspektimit , në raport me marrëdhëniet e punësimit, sigurinë dhe shëndetin në punë dhe standarteve të përkujdesit shoqëror.
- Përmirësimi i infrastrukturës në nivel qendror dhe local
- Rritja e profesionalizmit të inspektorit të punës, përmes trajnimeve dhe asistencës së vazhdueshme .
- Vazhdimi i procesit për dixhitalizimin e arkivës ekzistuese për dosjet e inspektimit
- Përmirësim i infrastrukturës së Institucionit (Administratë qendrore dhe Lokale), në pajisje zyre dhe informatike.
- Procedura e inspektimit online e kryer nëpërmjet portalit “e-Inspektimi”. Për vitin 2015 është punuar nga ana e ISHPSHSH-së në bashkëpunim të vazhdueshëm me Inspektoratin Qëndror për arritjen e këtij objekti. Aktualisht në sistem janë pasqyruar me të gjithë të dhënat e inspektimit 1577 subjekte. Këto inspektime nuk janë pasqyruar në kohë reale gjatë kryerjes së procesit të inspektimit. Konsiderohet i porealizuar, si objektivi për sa kohë nuk është arritur kryerja e inspektimit dhe pasqyrimi i tij, në kohë reale në portalin “e-Inspektimi”.
- Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shoqërore, nëpërmjet procesit të intensifikimit të inspektimit të subjekteve dhe ndjekjes në vazhdimësi të standarteve të përkujdesit shoqëror.
- Inspektim subjektet publike dhe jopublike sipas Matricës së Veprimtarive të Planit
- Inspektime të kërkesave, ankimeve, vlerësimeve për marrje Liçense të subjekteve të ardhur nga MMSR, SHSSH etj.
- Pjesëmarrje në Seminare, konferenca, trajnime në lidhje me Inspektimin e Shërbimeve Shoqërore dhe mbrojtjen sociale të përfituesve.

- Rritje e fokusit për identifikimin e viktimave të trafikimit të të gjitha formave, koordinimi i punës me inspektorët rajonalë për identifikimin e punës, për identifikimin e viktimave të mundëshme të trafikimit dhe punës së detyruar.
- Ndjekja e orientimeve nga Grupi Qendror i Punës për viktimat e trafikimit, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe Koordinatorin Kombëtar.
- Rritja e cilësisë së shërbimeve të reja të integruara së fundi në përkujdesjen shoqërore, si shërbimi i emergjencës, shërbimi në shtëpi.